REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3216/7 Prot. Sarandë, më 29.12.2025

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :23.12.2025
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar i Bashkisë Z.Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Vesel Koçiu
6. Denisa Islamaj
7. Përparim Ahmeti
8. Thanas Gurma
9. Lindita Kondi
10. Xhino Jaçaj
11. Bejdo Çela
12. Anjeza Dike
13. Dafina Allkushi
14. Eugen Qëndro
15. Elona Mano
16. Ermir Hoxha
17. Farie Hyska
18. Ilva Qëndro
19. Klejdjan Murtaj

20. Kevin Alikaj
21. Ibrahim Bajrami
22. Indi Rrapaj

Mungojnë :

23. Angjele Lapa
24. Katerina Beqo
25. Pranvera Osmani
26. Shpëtim Ahmeti
27. Laureta Çeçi
28. Dritan Peçi
29. Enea Vasili
30. Ilirjan Gërdhuqi

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 23.12.2025, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Nëntor 2025".
2. **P/vendim**"Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për mujin Nëntor 2025".
3. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë ,të pasurisë me nr.395,nr.409,nr.432,nr.430,nr.441 me sipërfaqe 328.534 m^2 zona kadastrale 1722".
4. **P/vendim**"Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 49.256 (dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë për pasuritë pronë private , që preken nga investimi publik me objekt "ndërtimi i urës së Metoqit", fshati Metoq, Sarandë"
5. **P/vendim**"Për miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026 – 2028 për Bashkisë Sarandë".
6. **P/vendim**" Për korrigjimin e gabimeve materiale".
7. Informacion mbi raportin e performancës së Bashkisë Sarandë për vitin 2024.

Gjergji Imeraj: kërkojmë që të hiqet pika gjashtë për shkak se materialet për korrigjim e gabimeve nuk kanë ardhur në kohë dhe të shtohet në rendin e ditës , **projektvendimi** "Për

miratimin e shtetasit M.K për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë".

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga z.Imeraj.

Miratohet me 22 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin nëntor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 22 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin nëntor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 22 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë,të pasurisë me nr.395,nr.409,nr.432,nr.430,nr.441 me sipërfaqe 328.534 m^2 zona kadastrale 1722".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Ibrahim Bajrami : Dua të falenderoj administratën që e bëri të mundur këtë gjë, kërkesën për ta bërë.Do të thosha që është e vonuar, megjithatë, më mirë tani se sa asnjëherë. Në të njëjtën kohë, do të doja të kujtoja që ka plot prona të tjera të cilat i hyjnë në punë Bashkisë Sarandë, të ardhmes së fëmijëve tanë, të cilat duhet të kalojnë në administrimin e Bashkisë Sarandë. Jemi praktikisht edhe me diskutimin e një buxheti tjetër, ku ne nuk i shtojmë absolutisht asnjë gjë të re fëmijëve tanë, nga vlerat që u lanë dikur në '91. Duhet të kishim më shumë shkolla sesa aq, duhet të kishim më shumë fusha futbolli sesa aq, duhet të kishim më shumë fusha volejbolli sesa aq. Ka plot toka, i nderuar kryetar, sot Saranda është në administrimin tuaj, bëni kërkesa të tilla sa

më shumë që të keni mundësi të administroheni dhe të rregulloni, të kemi një fushë tenisi për Sarandën. Pse s'do ta kemi një, dy fusha volejbolli, një park sportiv? Dikur na dukej larg ku kishim fushën e futbollit, sot është qendra e Sarandës. Le të marrim një vend tjetër që na duket larg sot, do të na duhet. Të gjithë kanë makina, shumica të paktën, po edhe vendosja e një autobuzi nuk na bën dëm. Të kishim terrene sportive, le t'i kemi jashtë Sarandës, le t'i kemi në Vurg, fusha shtet, kemi sa të duash, t'i marrim dhe t'i bëjmë.

Oltion Çaçi : Patjetër që i kemi, i kemi bërë dhe projektet. Meqë mu drejtove mua edhe, pavarësisht se Saranda është kufizuar te kjo pjesë dhe nuk i përkasin territorit të Sarandës, por në bashkëpunim me Bashkinë e Finiqit ne kemi një projekt shumë të mirë le të themi në embrion, për të krijuar një ambient totalisht sportivo-turistik. Shpresojmë tani të marrim miratimin sepse investimi është shumë i madh, na është dhënë një dakordësi nga qeveria qëndrore, nga kryeministri Rama, por pa u bërë le të themi 100% reale, atëherë është kot që të flasim sepse ndoshta dhe mund të dalim para qytetarëve dhe të gënjejmë. Por më mirë ta mbarojmë këtë punë dhe pastaj të komunikojmë. Por shumë gjëra janë bërë ndërkohë: shumë fusha, shkolla, ambiente sportive, të gjitha këto të rregulluara. Nuk e di po ke qenë në terren, po edhe po s'ke qenë do të çojmë edhe ato që kanë qenë në gjendje të degraduar. Së shpejti të gjitha rekuperohen.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 22 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 49.256 (dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë për pasuritë pronë private , që preken nga investimi publik me objekt "ndërtimi i urës së Metoqit", fshati Metoq, Sarandë" .

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 22 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Largohet nga salla këshilltarja Farie Hyska

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026 – 2028 për Bashkisë Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Gjergji Imeraj : Ky është një projektbuxhet që vazhdon investimet në Bashkinë Sarandë, vazhdon performancën e rritjes së buxhetit jo vetëm në mbledhjen e të ardhurave, jo vetëm në administrimin e mirë të tyre, por kjo është edhe e dukshme në komunitet. Në të gjitha cepat e

Bashkisë Sarandë shikon projekte të cilat do të investohen nga buxheti. Nga ky buxhet që kemi votuar ne të gjithë bashkë, është e vërtetë që edhe në këtë buxhet të këtij viti ne kemi ndërhyrë disa herë sepse vetë administrata është treguar e gatshme që atje ku fondet bllokohen, kalojnë projekte të tjera duke e riparë buxhetin. Dhe kjo riparje e buxhetit gjatë vitit e bëri efektiv edhe investimin, pra, duke parë më globalisht. Sepse ndoshta mund të ketë hollësira që mund të diskutojnë kolegët, është një buxhet që është frymëzues, është një buxhet që vazhdon atë rritjen e Bashkisë Sarandë në investimet nga buxheti i vet, përveç investimeve nga qeveria. Janë ulur shpenzimet administrative dhe është rritur koeficienti i shpenzimeve ose investimeve publike, të cilat sjellin rrugë, sjellin parqe etj., që edhe njëherë tjetër i kemi parë të gjithë, i shijojmë të gjithë dhe ka për të ndrequr, sidomos një gjë dua ta theksoj meqë kam fjalën, tek investimet e qeverisë ose të Fondit Shqiptar. E shohim me sy se sa probleme kanë pedonalet, sidomos lokalet në të gjitha këto akse, që nëse nuk është marrë në dorëzim ky projekt, duhet që bashkia ta detyrojë firmën që të sigurojë të gjitha lokalet, të gjitha kasetat dhe të gjitha defektet që janë krijuar tek investimi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Ibrahim Bajrami: Këtu që kemi të transferuara nga buxheti i sivjetshëm, gati gjysmën e të ardhurave të Bashkisë. Gati vlera 4 milionë euro kalon për vitin 2026, janë lekë të cilat janë shumë të domosdoshme, duhet të ishin shpenzuar. Kush e di se sa sheshe rreth e rrotull qytetit të Sarandës ku janë prishur mure, gardhe dhe kanë ngelë të pariparuara, të pa menaxhuara, kanë ngelë të shtruara me pllaka. Një pjesë e madhe e tyre, dikur të paktën, ishin edhe me gjelbërim. Një pjesë e madhe pemëve u shkulën që andej. Nuk jam kundër asaj që u bë, ju falenderoj, biles për atë që u bë, por ama duhet që të kujdeseshim. Kjo politika e transferimit të lekëve për vite elektorale më duket e papërshtatshme që të gjithë jemi duke e vuajtur këtu në këtë qytet dhe duket sikur kemi shitur rehatin tonë për turizmin. Në të njëjtën kohë, shikoj që nga të ardhurat tona, duke shfrytëzuar këtu edhe turizmin, ne nuk nxjerrim dot aq sa ka nevojë aparati i bashkisë. Më duket se duhet të dalim një çik nga lëkura e këtyre, jo vetëm për buxhetin këtu, por e kam llafin edhe për paketën fiskale. Nuk e di se ku është problemi që ne nuk i nxjerrim dot lekët që kemi të nevojshme nga turizmi. Të gjithë e kemi shitur rehatin tonë për shkak të turizmit, edhe ata që merren me turizëm dhe ata që s'merren me turizëm. Kemi trafik, kemi problematika të pafundme gjatë beharit. Shumica jonë nuk çojnë dot fëmijët në plazh për shkak të administrimit të territorit. Këtu nuk kam pyetje, pyetjen kisha vetëm tek ajo katër milionët.

Vesel Koçiu: Një pyetje për sa janë realizuar për vitin 2025 shpenzimet kapitale, planifikuar për vitin 2025, në çfarë përqindjeje.

Teuta Stroka :Për pyetjet, atëherë, përsa i përket realizimit të buxhetit, unë nuk kam një shifër të saktë se sa janë realizuar, por janë realizuar diku te 80% të lidhjes së kontratave dhe diku te 45% për të realizuar për financim, pra që janë financuar. Kemi këtë fond sepse edhe vitin e kaluar edhe këtë vit janë parashikuar investimet me financim dy vjeçar, pra 25-26 ose 26-27.Nuk mund të jem e saktë tani 80% e kontratave, jo realizim. Por realizimi për financim është rreth 45%, sepse kemi edhe në këtë moment.

Zoti Bajrami ishte i shqetësuar për fondet e trashëguara. Atëherë, këto fonde nuk janë të sivjetshme vetëm si buxhet të trashëguara, por janë fonde që trashëgohen pak a shumë vit pas viti dhe nuk janë fonde vetëm që tregojnë që buxheti nuk është realizuar, por janë fonde që tregojnë që buxheti edhe është tejkaluar. Për sa i përket disa zwrave të buxhetit, siç thatë ju tek paketa

fiskale që nuk ka ndryshuar, por tek të ardhurat, janë rritur të ardhurat nga turizmi, nga taksa e fjetjes në hotel.

Po janë rritur, pothuajse mos të them edhe 100%, edhe nga zëra të tjerë përsa i përket ndikimit të turizmit. Pra, të ardhurat nga viti 2023 deri tani janë rritur diku tek 60%, kështu që kjo tregon që këto nuk janë të trashëguara sepse ne s'po realizojmë dot investimet. Ndërkohë që investimet janë dyfishuar. Fondi i investimeve në krahasim me vitin 2023 ose dhe nga një vit më parë janë shtuar 20%. Pra, vit për vit fondet e parashikuara për investime rriten me një përqindje të konsiderueshme dhe të gjitha këto janë nga realizimi i të ardhurave tona, jo nga buxheti i shtetit. Kështu që këto janë tregues që faktojnë që performanca e buxhetit të Bashkisë Sarandë të paktën këto vitet e fundit, edhe falë rritjes së turizmit, është mjaft mirë.

Ermir Hoxha : Dalim te aspekti kulturor. Nga aspekti kulturor, ne kemi një cen me të cilin ballafaqohemi çdo ditë dhe brenda së cilës jemi, sepse kjo është godina e qendrës kulturore të cilën e vuajmë. Por unë po pyes, a kemi ne mundësi sot, zonja Teuta, edhe zoti Kryetar, të kemi buxhete pak, pak kurajoze, pak guximtare.

Oltion Çaçi: Po të lexosh buxhetin me vëmendje, po e shikon që për herë të parë Bashkia Sarandë përfundimisht vendosi që këtë godinë ku jemi sot, ta investojë totalisht bashkia Sarandë. Duke qenë se e përmende kulturën, sportin dhe artin, ne, pasi filluam me sportin, dhe nuk mund ta mbyllnim pa prekur edhe kulturën. U munduam dy vjet rresht që të fitonim buxhetin nga qeveria qendrore, në pamundësi dhe në shtyrje afati ku mund mos t'ia dilnim dot, dhe kjo ka qenë një nga arsyet që mosrealizimi i buxhetit. Sepse një vlerë e madhe e caktuar, ne gjithmonë ia linin kësaj godine këtu dhe prandaj dhe në shifra, në përqindje, pastaj themi pse nuk ishte realizuar buxheti, sepse ajo vlera nuk realizohet çdo vit nga që vitet për këtë destinacion. Tashmë vendosim si Bashki Sarandë që të gjithë financimin ta kryejë bashkia e Sarandës. Kuptohet, do ta shtrijmë në dy vjet financimin, por nga viti tjetër kjo godinë ku ne sot po zhvillojmë këtë mbledhje bashkë me ekipin, të gjitha do fillojmë punimet për rikonstruksionin e saj .

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 1, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e shtetasit M.K për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një

Miratohen me 21 vota pro, abstenim 0, kundër 0.
Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

Informacion mbi raportin e performancës së Bashkisë Sarandë për vitin 2024.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 7 (shtatë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj